



PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË X TË RREGULLT TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 02.11.2015 (e hënë) në Zyrën e drejtorit të Administratës, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje prezantuan 7 anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa. Të pranishëm ishin edhe nënkryetari i Komunës z. Hasan Aliu, drejtorët e drejtorive përkatëse, zyra e OSBE-së, , mjetet e informimit dhe zyrtarja e Zyrës Ligjore. Pasi u konstatua se prezent janë të gjithë anëtarët të KPF-së, andaj kemi kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi: Përshëndetje dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e X të rregullt të KPF-së!

Më lejoni së pari të përshëndes nënkryetarin e Komunës z.Hasan Aliun dhe ju të respektuar anëtarë të KPF-së, OSBE-në, anëtarin e komitetit me aftësi të veçanta, e cila është këtu si dhe anëtarët e komitetit për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, media të shkruara dhe ju gjithë të pranishëm. Para se të kalojmë në rendin e ditës: A ka dikush nga ju anëtarë ndonjë pyetje, ndonjë propozim?, fjala është për ju. Pasi nuk ka të interesuar për diskutim paraqes këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e IX e KPF -së të Vitisë.
2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar- shtator 2015.
3. Draft strategjia komunale kunder dhunes në familje dhe plani i veprimit 2016-2018
4. Propozim Rregullore mbi përshkrimin e detyrave të punës të punëtorëve arsimor. dhe organizimi e punës në institucionet edukativo - arsimore në komunën e Vitisë .
5. Propozim vendim për aprovimin e Planit të Punës të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara për vitin 2016 .
6. Propozim vendim për aprovimin e Planit të Punës të Komitetit Konsultativ për Pjesëmarrjen e Qytetarëve në Vendimmarrje për vitin 2016.

Kryesuesi: A ka dikush rreth rendit të ditës ju lutem?, nëse nuk ka e hedhim në votim për miratim. Konstatohet se me vota unanime miratohet rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Kuvendit Komunal të Vitisë.

A ka dikush rreth pikës të rendit të ditës?, hapim debat. Nëse nuk ka e hedhim në votim për miratim këtë pikë të rendit të ditës. Konstatohet se me vota unanime miratohet pika e parë e rendit të ditës.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar- shtator 2015

Ftoj drejtorin e drejtorisë përkatëse që ta merre fjalën rrethë kësaj pike të rendit të ditës.

z.Ibrahim Rama. Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, si zakonisht për qdo tre muaj drejtori për financa ekonomi dhe zhvillim ka për obligim ligjor të paraqes para KPF-së dhe para kuvendit ekzekutimin e buxhetit të aprovuar të vitit, për vitin e kaluar është fjala për buxhetin e aprovuar vitin e kaluar është fjala për buxhetin e vitit 2015. Pasi materialin e keni marrë me kohë nuk do të ju marrë ma shumë kohë, për pyetje përgjigje jam në dispozicion tu ndihmojë.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës.

znj.Mirlinda Sadiku: Drejtor, do të ishte mirë që në seancë të na sjellësh edhe listën subvencioneve që i ka ndarë kryetari, se gogjo një përqindje të lartë e ka bërë në ndarjen e subvencioneve, e ka kërkuar Bekimi që disa seanca, ndoshta një fletë më tepër nuk do të shkaktonte dëm. Ajo çka më intereson te shifra 13509, faqe numër 4, është një shumë gogja e madhe 107615 euro: A ke mundësi me na treguar çka janë këto pajisje tjera? Pastaj për projektet gjithmonë komitet e kemi dhënë vërejtjen që kur janë asfaltuar rrugët me ditur se cilat rrugë megjithatë nuk janë sjellur kilometrat se sa janë shtruar në Beguncë, Gërmovë, Goshicë, Kabash, prandaj nuk do të prishte punë me na i dhënë përafërsisht se sa kilometra janë shtruar, sa të holla janë shpenzuar. Prapë shërbime kontraktore tjera te buxheti dhe financa 6823 euro nuk specifikohet se çka, kjo po kalohet gjithmonë me përsërit veten, po përsëritet çdo komitet që nuk po specifikohet. Sa i përket drekave zyrtare, më dorështrënguari është treguar kryesuesi, sepse në qoftë se e sheh në mënyrë kumulative shuma po na del gogjo e lartë, gati 18000 euro veç dreka zyrtare. Po ashtu prapë drejtori i Arsimit 1117 euro, edhe më intereson drejtor tek administrata dhe personeli furnizim me veshmbathje 1140 euro, po më intereson kush ka ble ndonjë katllëk, më intereson për çfarë lloj veshmbathje.

z.Bekim Azizi: Kjo pikë është e rëndësishme, sepse japim një raport në bazë shpenzimeve që janë bërë, të buxhetit që është planifikuar, atë që na preokupojnë që janë shembull shërbime kontraktuese tjera që një pjesë e madhe është te Drejtoria e Rinisë, te shërbimet intelektuale të ndryshme, ndoshta pak na i jep një sqarim, faqe 3, 10900 euro, na jep një sqarim në fund, e shohë se te shpenzimet kapitale në krahasim me vitet tjera në këtë vit është pak ma mirë edhe se për mua prapë është e vogël 40%, se mendoj për 9 muaj së paku 60% u dashtë mu kanë, mirëpo është një lëvizje për të mirë në krahasim me vitin e kaluar, dhe te pagesat që shihet që janë bërë, shihet se te pagesat janë mbetur në gjysmë se nuk janë bërë pagesat komplete. Te subvencionet e shohë te Drejtoria e Bujqësisë vetëm 15 mijë euro janë dhënë prej 94 mijë euro që janë të ndara. Te hyrat vetanake të tatimit në pronë, vetëm shihet se është një ngecje, mendoj që këtë tre mujor vetëm ndoshta pak merret ma seriozisht për mi rritë këto vlera, kemi edhe një pjesë të mobilet, nuk e di ndoshta ka pas furnizim për shkolla, qa më ra në sy te mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, këtë 17 mijë euro, ndërsa vitin e kaluar i kemi pasur 10 mijë, këtu është një rritje e madhe te pas parasysh se një pjesë të kerreve vitin e kaluar i keni marrë të reja.

z.Daut Xhemajli: E rëndësishme sipas meje është që këtë 9 mujor në aspektin negativ te shpenzimi i buxhetit për projekte kapitale, për mua është brengosëse vitin e kaluar përafërsisht njëjtë ka qenë edhe e kemi pas fal se ka qenë viti i parë i qeverisjes edhe vështirësitë, inkorporimin, problematikat etj, po tash po e shohë se nuk është faji i udhëheqjes sa është funksionimi i administratës, sepse me shpenzu këtë buxhet unë ndoshta e kam parasysh edhe

çështjen se është fundi i vitit, tash jemi në nëntor, por problemi është se është kanë planifikuar që mu hargju ky buxhet në këtë formë edhe këtë 9 muhor kemi këtë përqindje të vogël, del që as planifikimi e as realizimi i projekteve nuk është në rregull të pasur parasysh vonesat në planifikim të projekteve të realizimit, procedura tani në realizimin e projekteve. Ndoshta për drejtorin është me rendësi me ditë a ka pasur tejkalime të këtyre afateve, a ka pasur vërejtje të kompanive e tjera pse nuk është realizua, do me thanë ky buxhet ose shpenzimi i këtij buxheti, por te pas parasysh se na jemi në fund të këtij viti e administratat duhet me u merr me planifikimin e buxhetit të vitit tjetër, unë mendoj se e njëjta do na ndodh edhe vitin tjetër, nuk dua me zgjat ma shumë me mos planifikime tjera, sepse kjo kam menduar se ka me ndryshu, po nuk mund me u ndryshu përkundrazi po duket se ka edhe ngecje, keq është se brenda administratës punët nuk kryhen edhe ju duhet me marrë me kontrata në vepër, kishe me i krye ato punë. Unë mënoj se është keq edhe ky shpenzim i buxhetit në këtë kategori duhet me u ndërpre, e njëjta është edhe ajo shërbime intelektuale, edhe aty nja 10 mijë euro, nuk është çështja te shuma, po mendoj sa a ka qenë e domosdoshme ajo nuk e di, po mendoj se nuk është mirë, sivjet kemi dënime nga gjykata dyfish ma shumë. Unë kam një breng se gjithë kjo shumë ka mbetur për tu hargju në tremujorin e fundit dhe duke u ngutur për të përfunduar punimet mundet diçka me metë keq. Tani te projektet kapitale, unë mendoj se është defekt që nuk po merremi si administratë, te shpenzimi analitik i shpenzimeve, do firma begi mirë i kanë vu lidhjet me komunën dhe a kanë drejtë a nuk kanë drejtë ajo është qështje tjetër. Vërejtje te të hyrat kam te shfrytëzimi i hapësirës publike edhe kjo farë qiraja për hapësirat publike, që unë mendoj se edhe nuk është e planifikuar drejtë edhe e realizuar shumë pak, që mendoj se duhet me i kushtua kujdes ma shumë.

z.Sami Demelezi: Ma lëshoj rendin Dauti dhe lidhem me ty, kur viti parë ka përfunduar shumë mirë viti i dytë mendoj se do të përfundoj shkëlqyeshëm, e dimë se gjithherë synohet të arrihet 100%, mirëpo edhe shifra prej 82.02 % e ekzekutimit të buxhetit konsideroj se është një shifër në nivelin që knaqë, gjithashtu edhe shkalla e inkasimit prej 84.06% konsideroj se është në këtë nivel, mirëpo edhe unë si Mirlinda po thuaje se për çdo tre muhorë po themi se këto pajisje të tjera, p.sh.: edhe unë kam këtë vërejtje, thjesht le të thuhet 2 apo 3 e pastaj të tjera, ama me ditë pak a shumë se ku dh qka kemi të bëjmë me këtë, dhe krejt në fund konsideroj se përfundimi i vitit do të jetë buxheti i shpenzuar afër 100%.

z.Ali Bajrami: Pjesa dërmuese e vërejtjeve këtu u thanë, unë isha ndal te pasqyrat që i ka përgatitur drejtori i Financave, nëse i marrim i shikojmë të gjitha drejtoritë shpenzimi i buxhetit nëpër të gjitha drejtorit e ka kaluar 80%-shin, projektet e parapara, ato që kanë qenë të votuara edhe që i kemi realizuar 45%, kur të marrim edhe afatin kohorë deri sa kemi, deri në fund të vitit, besoj se të gjitha do të kryhen në mënyrën ma të mirë të mundshme. Ato që i kam analizuar, që më kanë ra në sy, se këto dreka zyrtare janë bë aq të famshme se po mendon dikush a mos është ti qu në shpi, merre DKRS-në, Zyrën e Kryetarit dhe Drejtorinë e Arsimit, drejtorit tjera, pjesa dërmuese asnjë cent nuk e ka shpenzu. do me thanë janë shumë të përgjegjshëm sa i përket buxhetit edhe nuk është një qeveri se është tu jetua në lluks, por vetëm ato qa janë të domosdoshme. Një sqarim drejtor, shpenzimet postare kodi 13 330 4680 euro, këtu te pasqyrat të hyrat vetanake të planifikuara dhe të realizuara nëpër disa drejtori kemi ngritje të hyrave, në disa kemi një përqindje ma të ultë po ato kanë qenë të planifikuara, ku planifikimi mund me dështu me realizimin. Tjetra qka kam, shpenzimet 2014 - 2015 për 18 mijë euro që janë ma pak, e kemi diskutu shumë këtë çështje, shumë faktor kanë ndikuar për këtë zvogëlimin e të hyrave vetanake, besoj se me një angazhim do të kemi edhe aty përmirësim të përqindjes. Prezantimin analitik, ku janë asfaltimi i rrugëve rurale, me përjashtim të 2-3 fshatrave, pjesa tjetër është në realizim e sipër, që edhe ato besoj se do të përfundojnë në afatin ligjor.

Kryesuesi: Pasi nuk kemi tjerë për të diskutuar, kisha lut drejtorin ta merr fjalën se u shtruan një numër i madhe i pyetjeve.

z.Ibrahim Rama: Unë të gjitha kritikët i marrë normale dhe ato kur kanë politik brenda dhe ato pyetje kur nuk kanë politik. Unë i bëra gati dy vite para juve tu rrëfye për punën e drejtorisë edhe komplet të qeverisë komunale dhe çdo herë jam mundu deri sot dhe do të mundohem deri në fund të mandatit, që me qenë shumë i sigurtë në mënyrë profesionale jo politike dhe atë të jeni shumë të sigurt që ka me ndodh kështu dhe në këtë kuptim do ti jap edhe përgjigjet. Disa pyetje nuk kanë edhe përgjigje kur bëhen në mënyrë paushall, pasqyrat financiare kanë një kuptim, paraqesin shpenzimin e buxhetit, që e keni miratu ju ma pak ma shumë këto nuk e kanë kuptimin vetëm mu krahasua me atë që e kemi aprovuar. Një pyetje ishte se mua përherë më bënë përshtypje edhe përherë jam mundu me shpjegu në mënyrë të sigurtë, profesionale pse në investime kapitale përqindja e vogël, gjitha kategoritë ekonomike në përqindje janë në nivel të knaqshem dhe këtu unë e kam shpjegu edhe në KPF-në e kaluar edhe kam thanë se të gjitha shpenzimet për të gjitha kategoritë ekonomike i kemi me planifikim të alukimit të mjeteve në qdo tremujor, ne kemi arritë që me 30 shtator ti kemi mjetet e të gjitha projekteve që do ti kryem, kjo është e siguar, Ekzekutimi në teren me thanë që nuk kemi vërejtje gaboje, nuk po tregoj drejtë, kemi vërejtje po nuk janë vërejtje të karakterit që do të na i prishin substancën e investimeve kapitale. Ne jemi mundu me vendos një disiplinë ku çdo ditë në ora 8 me dhënë raport për punët që janë krye dhe një disiplinë e fort financiare jam mundu me instalu që nuk ka punë pa u përfundu me u pagua. Te të hyrat vetanake, po është një sfidë e qeverisë komunale dhe ne po mundohemi që ta bëjmë rritjen e të hyrave vetanake nëpërmjet inkasimit, një defekt për të është edhe falja e borgjëve, kjo ka ndiku shumë në qytetaret që nuk e kanë pagua pjesën e obligimeve të tatimit në pronë, me ardhjen e udhëzimit administrativ para dy jave për pagesën e borgjeve ka fillua rritja e pagesave dhe do të ju afrohem vlerës së planifikuar. Disa parametra tjerë në kodet ekonomike, p.sh.: po nisem prej fundi z.Aliu e bëri një pyetje, kodi ekonomik 13 330 4 mijë 680 euro, ky pozicion përmban fakturen e postës, që kemi për shpërndarjen e fakturave të tatimit në pronë. Po vazhdoj me Samiun, edhe ky ka bë një pyetje për kodin ekonomik për shpenzime të kodit 13 509, ekskluzivisht shumë prej 90 mijë euro të BE-së, projektit “kros border” për financimin e shtëpisë së kulturës, në këtë rast është fjala për aparaturën e kinemasë që e kemi instalu në shtëpinë e kulturës. Lista e subvencioneve nuk paraqitet në pasqyrat financiare, lista e projekteve që të parashihen, ku kanë mbërrit edhe kjo është një problem në veçanti ajo shpjegohet në raportin e prokurimit. Struktura e subvencioneve, p.sh.: është prej krejt shumë të shpenzuar për subvencione 87 mijë e 885 euro janë subvencione të shpenzuara nga Zyra e Kryetarit, 15 mijë janë nga Drejtoria për Bujqësi, 11 mijë e 610 janë shërbime sociale dhe 26 mijë 994 euro janë nga DKRS-ja. Ishte një pyetje, kodi 13 501 për pajisje, shuma ma e madhe që përfshin janë në Drejtorinë e Arsimit, Kontratat për shërbime të veçanta, ky është një proces tash unë nuk kam ndonjë sqarim, por vetëm atë se aq mjete janë shpenzu. Ju falënderoj për dëgjim edhe një herë, nëse kam harrua ndonjë pyetje ju kërkoj falje.

Kryesuesi: Drejtor, ishin edhe nja dy pyetje rreth shërbimeve intelektuale dhe një pyetje nga Mirlinda për vesh mbathje në Drejtorinë e Administratës.

z.Ibrahim Rama: Për veshmbathje nuk më kujtohet çka u ble, ndërsa shërbime intelektuale 10 mijë e 900 euro edhe kjo është pjesë e projektit “kros border” të BE-së, që janë paguar shërbimet në DKRS-në.

Kryesuesi: Drejtor ndoshta do të ishte mirë, se vazhdimisht nga ana e këshilltarëve po thuhet nga anëtarët, se qeto kodet të cilat janë pak jo boll të informuara për ne, ndoshta ka qenë mirë që pasqyrat e tjera të cilat na vinë me pasu me një sugjerim të shkurtër në mënyrë që mos të bëjmë vazhdimisht pyetje.

z.Daut Xhemajli: Sqarimet vazhdimisht janë të nevojshme, a ka mundësi drejtor me pas, se pasqyra e ekzekutimit faqe 3, jo krahasim me vitin e kaluar shpenzimet po të planifikuara sa kanë qenë këto shpenzime edhe realizimi i këtij viti deri në këtë 9 muajorë. Unë pa hy në substanca në thelbin e këtyre shërbimeve, mendoj që jo vetëm për këtë po për gjitha na duhet me pas jo krahasim me vitin e kaluar po me të ekzekutimin e buxhetit me planifikimin. Tjetra, të hyrat vetanake, ne e theksuam se një komunë që nuk angazhohet për këtë punë është problem, sa drejtorit i kanë pas planifikimet e sakta dhe sa i kanë realizua, p.sh.: drejtori i Arsimit qenka këtu, 22 mijë euro, sa janë realizu vetëm 6 mijë, pse, ku është defekti. Te Inspeksioni 100 euro i ka mbledh, d.m.th të hyrat nga inspektimet sa i ka pas të planifikuara 1900 euro, për me mat a janë duke funksionuar a jo.

Kryesuesi: Po shpresoj se drejtori në pasqyrat e vitit të ardhshëm do të ketë parasysh edhe këtë qatë po e kërkojnë anëtarët e KPF-së. Ja kisha dhënë fjalën nënkryetarit.

z.Hasan Aliu: Po lidhem pak te Dauti, domethënë shërbimet kontraktuese tjera, te gjitha ato te cilat nuk janë te parapara me kod specifik ti i qet qaty, tash nëse i hijm asaj të cilën po e kërkon ti, me siguru do të dalin pasqyrat shume polemike, por ne rast se e thua ne aspekt intern, a duhet ta ketë qdo shërbyes civil ne tavoline se sa i ka te planifikuara dhe çka ka me investuar është diçka tjetër. Megjithatë ato te cilat po i kërkon me dashtë me hulumtuar i ke ne shtëpi, jo vec ti, por të gjithë këshilltarët e Kuvendit të Komunës. Çështjen tjetër të cilën po e lyp këshilltarja Mirlinda, sa kilometra janë shtruar ne rrugën ne Skifteraj, Remnik, Beguncë e krejt ato unë besoj që do te kesh mundësi me i pa në raportin e kryetarit që e jep ne fund te vitit, edhe në atë raport kryetari del dhe tregon sa kilometra janë shtruar asfalt ne lokalitete te ndryshme, besoj qe nuk është shume problematike. Çështja tjetër, derisa Drejtoria për Kulturë ka pasur një aktivitet dhe nuk ka pasur buxhet te vetin për disa rekuizita të sportit e ndërsa është furnizuar nga Administrata dhe Personeli.

Kryesuesi: Unë atëherë po ju falënderoj te gjithëve për kontributin që dhatë rreth kësaj pike të rendit te ditës, dhe si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Draft strategjia komunale kundër dhunës ne familje dhe plani i veprimit 2016-2018

Ia kishim dhanë paraprakisht fjalën zyrtares për barazi gjinore.

znj.Ibadete Hyseni: Meqenëse strategjia është një dokument mjaft voluminoz, unë do të mundohem në pika te shkurta ta bëj një përmbledhje të këtij dokumenti. Grupi punues për strategjinë komunale dhe plani i veprimit për periudhën 2016-2018 në përbërje të 7 anëtarëve, e cila ka ardhur me vendim te kryetarit të komunës ju prezantojmë draftin me anë te këtij dokumenti. Hartimi dhe zbatimi i kësaj strategjie mundëson koordinimin e përpjekjeve ekzistuese të të gjithë dikastereve që trajtojnë çështjen e dhunës në familje. Qëllimi i vetëm i këtyre përpjekjeve është që te parandaloj dhe luftoj dhunën ne familje. Kjo strategji i referohet implementimit te planit nacional të veprimit kundër dhunës ne familje si dhe zbatimit te kuadrit ligjor, i cili ndër të tjera thekson hartimin e politikave të reja në nivel lokal dhe parandalimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave te dhunës ne familje, si dhe mbështetjen financiare të strehimoreve regionale që strehojnë këto viktimat. Në këtë strategji janë caktuar 4 objektiva strategjike, të cilat janë: pabarazitë gjinore, arsimimi dhe edukimi, fuqizimi i bazës ekonomike si dhe fuqizimi dhe bashkëpunimi ndërinstitutional. Për me tej këto objektiva strategjike janë zbërthyer në 12 objektiva specifike, për te cilat është hartuar një plan veprimi i detajuar me aktivitete, institucionet përgjegjëse dhe partneret për zbatimin e tyre, vlerësimet që lidhen me afatin kohorë të zbatimit të tyre si dhe planin e monitorimit. Sa i përket koston financiare për realizimin e objektivave, grupi punues nuk kemi caktuar ndonjë kosto, për arsye se ne dakordim

me menaxhmentin e lartë të komunës, gjegjësisht kryetarin e komunës, mbetet që kostoja financiare për realizimin e aktiviteteve të caktuara në këtë strategji të caktohet për çdo aktivitet dhe të bëhet kërkesë në formë të shkruar për ndarjen e mjeteve financiare dhe specifikimin e aktivitetit. Aktivitetet në planin e veprimit janë radhitur sipas tre shtyllave bazë të përcaktuara edhe në planin nacional të veprimit kundër dhunës në familje, parandalim, mbrojtje dhe riintegrim. Për arritjen e objektivave të kësaj strategjie aktivitetet janë specifikuar edhe sipas prioritetit në aktivitete afatshkurta, afatesme, afatgjate si dhe aktivitetet në vijimësi. Procesi i hartimit të kësaj strategjie e ka ndjekur një proces të gjatë diskutimesh, ku janë mbajtur takime publike me institucione të ndryshme gjegjëse, që merren me trajtimin e çështjes së dhunës në familje, por edhe me grupet e ndryshme të interesit, organizata të ndryshme të shoqërisë civile. Për zbatimin e kësaj strategjie obligohet Komuna e Vitisë me të gjithë sektorët e saj relevant si dhe të gjithë institucionet e tjera gjegjëse dhe partneret mbështetës. Si grup punues jemi munduar që në këtë dokument të bëjmë një analizë të situatës aktuale dhe problematikes, e cila shkakton dhunën në familje ku dhe kemi ardhur në disa përfundime, ku ndër shkaktohet kryesor të dhunës në familje janë pabarazitë gjinore, gjendja e rënduar ekonomike si dhe disa probleme sociale të cilat janë të cekura në këtë dokument.

Kryesuesi: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutem?

znj.Mirlinda Sadiku: Kam qenë pjesë edhe e grupit punues, kjo është një temë mjaft e ndishme, tash se fundmi e patëm fatkeqësisht edhe një rast me fatalitet, ma merr mendja që është momenti i fundit që qeveria dhe qeverisjet komunale të vetëdijesohen për këtë fenomen, i cili fatkeqësisht po na ndodh e po na merr jetë njerëzish çka është diçka e dhimbshme. Pasi që kam qenë pjesë e grupit punues gjithmonë e kam potencuar ta ketë një kosto financiare, kam insistuar në atë për arsye se ë fundmi ju e dini shume mire që në kuvendin komunal e kemi aprovuar një strategji komunale për personat me aftësi të kufizuar dhe asnjëherë nuk na është dhënë përgjigja dhe ajo ka nënkuptuar se nuk është menduar kostoja financiare, nuk është menduar të ndahet nga komuna asnjë cent. Me bëri përshtypje një paragraf ku thotë: “institucionet komunale të Vitisë janë të përkushtuara në parandalimin dhe luftimin e këtij fenomeni të dëmshëm për shoqërinë tonë në përgjithësi, atëherë si do ta luftoj Komuna e Vitisë dhe institucionet komunale kur nuk është ndarë një buxhet, nuk është ndarë një kosto financiare. Ta zëmë kjo vjen në kundërshtim me atë, p.sh.: e kemi një viktimë të dhunës në familje ku këtu si aktivitet në bazë të kësaj strategjie parashihet ofrimi i mbështetjes ekonomike përmes pagesës së qirasë rastet e pazgjidhura, p.sh.: ajo mund të shkojë te qendra që është për mbajtje në Gjilan, mirëpo pas 6 muajve ka mundësi duhet të kthehet prapë te familja e vet, atëherë komuna duhet t’i ofroj strehim asaj viktime në mënyrë që mos të jetë ajo prapë e atakuar me dhunë në familje, sepse mundet me pas një fund fatal, prandaj kosto financiare të kësaj strategjie uroj të ketë, është shume e qëlluar që mbështetja financiare e strehimores regionale të bëhet në përqindje të numrit të viktimave.

z.Bekim Azizi: Një pyetje, këtu shkruan martesë e hershme është shkelje e të drejtave të njeriut: Është paraparë moshë apo qysh? Këtu është specifikuar mbi 90% dhuna ndaj femrës, e këtu është problemi të dhuna familjare, që janë të përfshirë edhe fëmijët, të moshuarit, fëmijët. Unë mendoj që të moshuarit janë kategori më e prekur sepse përballen me mungesë respekti e përkushtimi. Sa i përket femrave, gjerat kanë lëvizur pozitivisht, ndërsa dhuna ndaj fëmijëve që kryesisht bëhet nga femra ndaj fëmijëve, sepse femrat janë në mbikëqyrje të fëmijëve.

z.Daut Xhemajli: Kjo me shumë është program komunal kundër dhunës në familje sesa strategji. E kam përvojën në këtë aspekt, sepse i kam parë të gjithë këta mekanizma që funksionojnë në nivel të Kosovës, shumë komuna me herët e kanë hartuar këtë strategji. Komuna

si një prej mekanizmave institucional të koordinoj aktivitetet në baza vullnetare me akteret policinë, prokurorinë, shoqërinë civile, qendrat e tjera për punësim e mirëqenie sociale, me qëllim që aktivitetet e tyre të mundësojnë parandalimin, mbrojtjen dhe rintegrimin e viktimave. Qëllimi i kësaj strategjie është forcimi i këtyre mekanizmave, bashkërendimi i aktiviteteve politike dhe monitorimi i aktiviteteve, raportimi për veprimet, në mënyre që të parandalojnë apo trajtojnë në mënyrë adekuate viktimat e dhunës në familje. Përshkrimi i gjendjes aktuale është dashur të jetë në fillim si hyrje. Unë e kam me vete programin kundër dhunës në familje në nivel të Kosovës, sikur të funksionon kjo shoqëri sipas atyre mekanizmave nuk do të kishte dhunë në familje, sepse duke filluar nga shoqëria civile, mediave të cilat sikur të informojnë menjëherë janë akterët që reagojnë dhe menjëherë trajtohen këto raste. Strehimoret e Kosovës financohen, megjithëse buxheti i tyre është i vogël prej Qeverisë së Kosovës, Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Vitia nuk ka asnjë marrëveshje me këtë strehimore regjionale nuk ka asnjë marrëveshje për të financuar apo ndihmuar në këtë strehimore. Sa i përket fushave të veprimit, në programin e Kosovës janë forcimi i institucioneve jo pabarazia gjinore, mentaliteti, tradita, fuqizimi i bazës ekonomike, edukimi dhe vetëdijesimi përmes shkollës. Unë mendoj që për monitorim dhe zbatim të kësaj strategjie duhet të jete komuna e Vitisë si e përgjithësuar ose koordinatori, dhe për vlerësimin dhe progresin e kësaj strategjie është Kuvendi. Sa i përket informimit duhet ta informojnë koordinatoren, pastaj kryetari informohet nga ai. Sa i përket buxhetit, të gjithë akterët e kanë buxhetin e tyre, p.sh.: policia e ka buxhetin e saj, strehimorja e ka buxhetin e saj, qendra për punë sociale ka zyrtar që paguhet për atë punë e të gjithë mekanizmat e tjerë që janë inkuorporohen.

z.Sami Demelezi: Unë do të isha ndalur të shifrat, tek kapitulli i arsimit nga 683 mësimdhënës 249 janë femra, prandaj del një përqindje mjaft e mirë mbi 36%, nga 22 drejtorë 3 femra, nuk është një përqindje me shpërblye, Kuvendi i Komunës 10 nga gjithsej 27, një përqindje mjaft e mirë. Ndërsa tek martesat e hershme është mjaft inkurajuese, sepse është vetëm një rast, ndërsa të divorcet është një statistike jo e mirë dhe brengosëse, sepse është në rritje, gjithashtu inkurajuese është edhe raportimi i dhunës në familje, është keq që ndodh dhuna në familje, por me keq është mos me u raportuar. Te plani i veprimit, sa i përket debateve nuk e di sa e kanë shikueshmërinë këto televizione, megjithatë është një plan i veprimit i mirë, por është problem me u realizuar të të gjitha këto objektiva.

znj.Ibadete Hyseni: Do të mundohem të përgjigjem në pyetjet, është fjala të martesat e hershme në Komunën e Vitisë, thamë se është shkelje e të drejtave të njeriut, sepse privojnë të rinjtë nga arsimimi, zhvillimi dhe perspektivat afatgjate dhe në rastet me të shpeshta që paraqitet dhuna në familje janë këto raste. Mandej, thotë se strategjia i referohet 90% femrave, ne ju kemi referuar situatës aktuale, sepse për vitin 2013, 2014 dhe 2015 të gjitha viktimat janë femra. Sa i përket Dautit, e kemi ftuar për konsulentë atë dhe Nuredin Lutfiun, por nuk na kanë ofruar ndihmë, ai tha që Komuna e Gjilanit, Dragashit e kanë hartuar këtë strategji, e për dallim nga ne janë përkrahur nga organizata të ndryshme. Sa i përket pse pabarazitë gjinore, janë përfshirë në fushëveprimin e kësaj strategjie, ne nuk iu kemi referuar vetëm komunës tone, por në gjithë vendin dhe kemi parë se burimi i dhunës në familje janë pabarazitë gjinore, strategjia nuk është dokument i mekanizmit, sepse mekanizmi është themeluar në qershor të këtij viti, ku kemi nënshkruar edhe një marrëveshje bashkëpunimi në mes 15 akterëve që trajtojnë çështjen e dhunës në familje, jo vetëm nga Komuna e Vitisë, por edhe disa nga akterët që janë në regjion, sepse në Viti nuk ka siç janë mbrojtësi i viktimave, zyra për ndihmë juridike falas, qendra për ndërmjetësim. Tjetra ishte për strehimoret, siç e di unë tash do të jetë një marrëveshje për financimin e strehimoreve, pasi që viktimat nga Komuna e Vitisë nuk strehohen vetëm në strehimoren e Gjilanit, por edhe në strehimoren e Ferizajt. Strehimi në strehimoren e Gjilanit

është 6 muaj, nga rasti specifik 1-2 vite, pastaj strehohen në strehimoret tjera regionale, kur viktimat është e rrezikuar nga shkaktuesi i dhunës strehohet në strehimoren për siguri të lartë në Prishtinë. Te plani i veprimit është e vërtete nuk kemi caktuar kosto financiare, por kostoja financiare më e lartë është për financimin e këtyre strehimoreve dhe në pagesën e qirasë së viktimit të dhunës në familje, ndërsa aktivitete tjera janë aktivitete që kërkojnë përkushtim të resurseve njerëzore.

z.Daut Xhemajli: Ju me keni ftuar pasi që e keni përfunduar dokumentin, prandaj unë nuk kam dashur dhe as nuk mundem me u inkuadruar pasi të përfundon një projekt, sepse unë nuk mundem me ndryshu, unë kam qenë koordinator i këtij programi në nivel të Kosovës dhe do ju kisha ndihmuar, por nuk mund të kyçem në fund të procesit.

z.Hasan Aliu: Me gjitha vërejtjet, nëse kemi strategji në nivelin nacional asaj duhet me iu adaptuar. Për sa i përket koordinatorit, unë kam qenë ihtar i asaj se koordinatori të jete i jetës institucionale, sepse po na paraqesin pagesat problem e po vdes vullnetarizmi, e për të qenë zbatuese kjo strategji do të ishte mire të kishte qenë Njësia për të Drejtat e Njeriut ose Qendra për Punë Sociale të ishte koordinatorë. Me gjitha vërejtjet në KPF, unë propozoj që kjo strategji të shkojë në kuvend me qëllimin me zënë afatin dhe ndërkohë të përmirësohet aty ku ka vërejtje.

Kryesuesi: Strategjia kundër dhunës në familje shtyhet për seancën tjetër.

Si pikë e tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim rregullorë për përshkrimin e detyrave të punës të punëtorëve arsimor dhe organizimin e punës në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Vitisë

z.Hekrem Shabani. Drejtorja e Arsimit ka hartuar këtë propozim rregullorë, e cila e rrit përgjegjësinë dhe efikasitetin e punëtorëve arsimor dhe organeve drejtuese të shkollës, ku kontribut të veçantë ka dhënë edhe zyrtarja e barazisë gjinore. Në shkollë janë dy lloje organesh, organe drejtuese dhe organet profesionale. Organe drejtuese janë drejtori, zëvendësdrejtori, Këshilli i Shkollës, Këshilli i Nxënësve, ndërsa organe profesionale janë arsimtari, profesori, mësuesi, kujdestari i klasës dhe kujdestari i ditës. Kjo është një rregullorë specifike, sidomos për ndalesat për mos përmbushjen e obligimeve të punës, për mungesat e punëtorëve arsimor në mësim, që kemi pasur shumë probleme se si të veprojmë, bile pa baze ligjore kemi vepruar, qëllimi ka qenë me vetëdijesë. Në këtë rregullorë në mënyrë taksative i kemi rregulluar këto aspekte. Rregulloren këtu e keni, jam i hapur për pyetje.

z.Daut Xhemajli: Po ndalem te kjo, punëtori arsimor nëse brenda një viti mungon pa arsye 5 ditë pune, përkatësisht 20 orë mësimi, i ndërpritet kontrata e punës ose nuk i vazhdohet kontrata për vitin vijues, inicohet procedure disiplinore. Sipas meje kjo është pa kuptim, duhet të jetë e tillë, punëtori arsimor i cili mungon brenda 1 viti pa arsye 5 ditë pune, përkatësisht 20 orë mësimi kundër tij duhet inicohet procedurë disiplinore për ndërprerjen e kontratës dhe nuk i vazhdohet kontrata e punës. Këtu te sekretari, ku thuhet se i zbriten 2 euro nga paga baze, punëtorit teknik i zbriten 3 euro nga paga mujore, nëse është paga baze atëherë është me përqindje. Pastaj thuhet për zbatimin dhe komentimin e kësaj rregullorë, për zbatimin mundeni me thanë përkujdeset shkolla, drejtoritë, ndërsa për komentimin e saj është Zyra Ligjore ose Kuvendi i Komunës, sepse komentim drejtoritë, çerdhja nuk bënë. Pastaj çdo dispozite e kësaj rregullorë që është në kundërshtim nuk mundemi me thanë, e që mund të jetë në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe udhëzimeve të tjera, atëherë vlen depozitat e ligjit, atëherë mund të thuhet.

z.Bekim Azizi: Këtu te ndalesat, a jen në bazë të ligjit ndalesat, unë kisha thënë nuk janë të cekura shembull arkivat profesionale, që e kanë një pune jashtëzakonisht të madhe, e te hartimi i orarit që përgatitet në shkollë të mëdha a do të jetë në bazë të orëve kompensimi apo si.

znj.Mirlinda Sadiku: Unë do të isha ndalur te emërimi i kësaj rregullore, sepse ne të përshkruhet pozita edhe e punëtorëve teknik, ndoshta do të ishte më mirë të emërohet rregullore për stafin menaxherial dhe punëtorëve teknik, me specifikuar, sepse brenda rregullores përshkruhen pozitat e tyre dhe ndëshkimet që mund ti kenë për moskryerje të detyrave të tyre. Po ashtu është propozuar nga Beka rregullorja për mësimin joformal, e konsideroj që është dashur të parashihet në këtë rregullore, sepse mbahet mësimi joformal, cili do të jete ndëshkimi për ata profesor qe nuk marrin pjese në mësimin joformal, që organizohet 12 javë, cila do të jete lartësia e kompensimit material. Do të ishte mire të organizohen takime e debate publike, sepse kjo ka të bëjë edhe me ndëshkimet për moskryerjen e detyrave të punës, sepse shume ka pasur vërejtje në rregullore qe e keni aprovuar vitin e kaluar për nxënësit.

z.Sami Demelezi: Në këtë rregullore i kam disa vërejtje, p.sh.: te neni 1 qëllimi i arsimit dhe edukimi i nxënësve dhe i vijuesve, çka nënkupton? Pastaj te Këshilli i Shkollës thotë: “drejtori i shkollës është sekretar i këshillit të shkollës dhe ka të drejte të propozoj zgjidhje dhe te marr pjesë në debat, por pa te drejte vote”. Sa herë ka te drejtë të mungoj anëtari i Këshillit të Shkollës dhe a duhet te mbahet procesverbal gjatë mbledhjeve që mban ky këshill, kujt duhet ti raportoj dhe sa mbledhje duhet se paku duhet ti mbaj Këshilli i Shkollës brenda vitit kalendarik, nëse Këshilli i Shkollës nuk mblidhet për një kohë të caktuar kush duhet ti marr përgjegjësitë dhe te organizoj zgjedhje te reja për Këshillin e Shkollës? Pastaj te këto gjodat dhe mua po me duket absurde me u dënu 2euro, 1 euro.

z.Ali Bajrami. Unë po ndalem këtu te drejtori, ku thuhet: “është përgjegjës për menaxhimin e listave të pagës dhe administrimin e tyre”, por nëse ka ndalesa a është prapë kompetencë e drejtorit, nëse pagat paguhen. Pastaj shqipton masat disiplinore te bazuara në ligj dhe rregullore sipas propozimit te kujdestarit të klasës, këshillit të klasës apo këshillit të arsimtareve, po ndaj personelit arsimore nuk e hasa askund apo janë te rregulluara me ligj e i kryen Drejtoria e Arsimit. Tjetër çka me ra ne sy Këshilli i Shkollës zgjidhet prej 5 mësimdhënësve dhe 3 prindërve, por tash këtu po ceket në rastin e shkollave të nivelit 2 dhe 3 të mesme, zgjidhet edhe 1 prej nxënësve, nëse aty ku nuk zgjidhet prej nxënësve çka po bëjmë, 4 me 4 çka bëjnë. Tjetra çka kisha pasur me cekur te anëtarët e Këshillit të Shkollës zgjidhet me votë të fshehtë, kryetari i këshillit të shkollës zgjidhet çdo vit nga këshilli nga radhët e përfaqësuesve të prindërve, këtu po thotë që mund të rizgjidhet a mundet 1 here a 2 here apo për afat të pacaktuar?

znj.Ibadete Hyseni: Meqë u lakua emri im nga zyrtari i Drejtorisë se Arsimit, unë konsideroj se e drejta për arsim është e drejte themelore e individit, meqë kjo rregullore do te del në debat publik propozoj që të shtohet edhe një depozitë për këshillin e prindërve, dhe tjetra është te ndalesat apo te masat ndëshkimore, nuk e di sa është harmonizuar kjo rregullore me rregulloren tjetër e cila është ne fuqi për masat disiplinore, po me duket se janë bërë ndëshkime të dyfishta, atje me masa disiplinore e këtu me gjoba për shkelje të njëjte.

z.Daut Xhemajli: Mendoj se neni 19 ku thotë: “për mosdorëzimin me kohë të punës të çdo punëtori drejtorit i zbritet 50% nga paga, unë mendoj se në fund te vitit shkollor duhet të bëhet vlerësimi, në rast se nuk e dorëzon punën me kohë në fund te vitit është 50%, por në rast se nuk e dorëzon fare duhet të shkruhet se iniciohet procedurë disiplinore.

Kryesuesi: Duke ju falënderuar për debatin konstruktiv, që kjo rregullore ta merr formën e duhur, e hedh ne votim që të shkoj në debat publik: Kush është për. Konstatoj se me votat unanime aprovohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katër të rendit të ditës kemi:

4. Propozim vendimi për aprovimin e Planit të Punës të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara për vitin 2016-2018

Kryesuesi: Meqenëse me Ligjin mbi Vetëqeverisjen lokale dhe Statutin e Komunës së Vitisë parashihet që të formohen komitete konsultative, në vitin e kaluar i kemi themeluar dy komitete, komitetin konsultativ për personat me aftësi të kufizuara dhe komitetin konsultativ për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, këta kanë punuar në këtë drejtim dhe ia kanë sjellur komitetit planet e punës për vitin 2016, atëherë unë e hapi debatin rreth këtij plani.

z.Daut Xhemajli: Është mirë që e kemi këtë komitet, por te aktivitetet e tilla, unë mendoj që rregullimi, jo eliminimi i pjerrinave për shkolla, duhet të jetë jo vetëm në 2-3 shkolla, por duhet në të gjitha shkollat të përfundoj në 2016.

z.Ali Bajrami. Te aktivitetet dhe mbështetja financiare te parapara për vitin 2016, është e udhës që të gjejmë mënyra ti mbështesim, sepse nuk qenka ndonjë kosto e larte financiare, andaj bëni përpjekje me Drejtorinë e Ekonomisë dhe Financave, që aktivitetet që janë paraparë të mos mbesin pa u realizuar për shkak të mjeteve financiare.

z.Bekim Azizi: Nuk e di sa iu kane përmbajtur strategjisë që e kemi miratuar për personat me aftësi të kufizuara 2016-2018, por mendoj që duhet ta kemi parasysh që çdo plan që e parashohim të jetë në përputhje me strategjinë e tillë.

Kryesuesi: E hedhim në votim: Kush është që të shkoj për miratim në Kuvend. Atëherë konstatoj me votat e të gjithë të pranishme miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. Plani i punës për vitin 2016 i Komitetit Konsultativ për Pjesëmarrjen e Qytetarëve në Vendimmarrje

Kryesuesi: Edhe ky është një komitet që e kemi themeluar, një mbështetje të madhe në funksionimin e tij është duke e dhen ATRC-ja në krye me Nora Sokolin. Jemi të parët në nivel të Kosovës që e kemi formuar dhe ja hekin mëditjet ata. Plani i punës i këtij komiteti pas shpërndarjes së materialeve për KPF është ndryshuar pas disa takimeve që kemi pasur. Hapim debat për këtë pikë të rendit të ditës.

E hedhim në votim që të shkoj për miratim në Kuvend. Konstatoj se me votat unanime miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Me kaq shpallë të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30

Procesmbajtës:
Ilir Zuka

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë
z.Naim Pira
